



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P.656/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.10.2019 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e shoqërisë “A.SH Engineering” shpk nga procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. Loti 1: REF-30645-07-17-2019, me objekt: “Loti 1: Shërbim Mbikqyrje Punimesh për objektin Rikonstruksion i shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi”, Ersekë”, me fond limit 789,110 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.07.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë”.

**Ankimues:** “A.SH Engineering” shpk  
Rr.”Vllazen Manastirliu”, pallati 11, shkalla 1, apartamenti 5,  
Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kolonjë  
Sheshi “ Rilindja ”

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë elektronike dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.07.2019 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. Loti 1: REF-30645-07-17-2019, me objekt: “Loti 1: Shërbim Mbikqyrje Punimesh për objektin Rikonstruksion i shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi”, Ersekë”, me fond limit 789,110 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë”.

II.2. Në datën 29.07.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 01.08.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “MAK Studio” shpk	648.034 lekë	skualifikuar
2. “Lead consulting” shpk & “HE-SK 11”shpk	656.182 lekë	kualifikuar
3. “A.SH Engineering” shpk	668.198,2 lekë	skualifikuar
4. “Zenit& Co” shpk	686.525 lekë	kualifikuar
5. “Novatech “ shpk	697.491,67 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 01.08.2019, operatori ekonomik “A.SH Engineering” shpk, referuar SPE, është vënë në dijeni mbi arsyen e skualifikimit të tij, si më poshtë vijon:

*“Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik A.SH. Engineering SHPK L31617003F Vlera e ofertës 668.198,2 ( Gjashtëqindgjashtëdhjetëtetëmijëenjëqindenëntëdhjetëtetë pikëdy ) lekë pa Tvsh . Vlera e ofertës 801.837,84 (Tetëqindnjëmijëtetëqindetridhjetëeshtatëpikëtetëdhjetë katër) lekë me Tvsh. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 , “ Për Prokurimin Publik ”, ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga operator ekonomik A.SH. Engineering SHPK . a.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.4.2,Kapaciteti Teknik , profesional kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë : Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesin një listë të personelit kryesor (Drejtues Teknik), të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponenteve të saj, si dhe CV-në e tyre, Diplomat, Kontratat individuale të punës të noterizuara dhe licencat në mbikqyrje të tyre. Drejtuesit Teknik të kërkuar më poshtë duhet të jenë në licensën e Mbikqyrje/ Koluadimit të Punimeve të Zbatimit të Shoqërisë dhe të figurojnë në listë pagesat e punonjësve të shoqërisë të siguruar me kohë të plotë pune për muajt Janar 2019 – Qërshor 2019 (Formularët E-Sig 025/a.1). Lista e Drejtuesve Teknikë, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit, të këtë: 1. Drejtues Teknik Inxhinier Ndertimi 2. Drejtues Teknik Arkitekt 3. Drejtues Teknik Inxhinier Elektrik 4. Drejtues Teknik Inxhinier Mekanik 5. Drejtues Teknik Inxhinier Gjeodet 6. Drejtues Teknik Inxhinier Mjedisi Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik A.SH. Engineering SHPK është konstatuar se nuk ka paraqitur dokumentacion për drejtues teknik Inxhinier Ndertimi dhe Arkitekt . Ndësa ,diploma e Drejtuesit Teknik Inxhinier Gjeodet me inicialet A.S nuk është origjinale OSE fotokopje e noterizuar sipas kërkesave të DST. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 46, pika 1, nenit 53, të Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,“Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ( i*

*ndryshuar), Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme ofertën e operatorit ekonomik A.SH Engineering SHPK pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.*

II.4.1. Operatori ekonomik ankimues “A.SH Engineering” shpk, sqaron se në datën 05.08.2019, ka paraqitur ankimin drejtuar autoritetit kontraktor në mënyrë elektronike, nëpërmjet faqes zyrtare elektronike të APP-së [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al), me anë të të cilit kundërshton skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi. Konkretisht pretendohet si vijon:

*“Shoqeria jone “A.SH Engineering” shpk eshte krijuar ne prill te vitit 2013 dhe operon ne Republiken e Shqiperise duke njohur dhe respektuar ligjet e saj. Ne oferten tone te dates 29.07.2019 kemi plotesuar cdo kerkese dhe dokumentacion te kerkuar ne DST nga autoritrti kontraktor Bashkia Kolonje per objektin : Sherbim Mbikqyrje Punimesh per objektin Rikonstruksion i shkollës se mesme "Petro Nini Luarasi", Erseke. Ne si Operator Ekonomik kemi paraqitur nje liste te personelit kryesor (Drejtues Teknik), te nevojshem per te zbatuar objektin e prokurimit dhe komponenteve te saj, si dhe CV-ne e tyre, Diplomat, Kontratat individuale te punes te noterizuar a dhe licencat ne mbikqyrje te tyre. Drejtuesit Teknik te kerkuar jsne ne licensen e Mbikqyrje/ Koluadimit te Punimeve te*

*Zbat imit te Shoqerise dhe te figurojne ne Iiste pagesat e punonjesve te shoqerise te siguruar me kohe te plote pune per muajt Janar 2019- Qershor 2019 (Formularet E-Sig 025/a.l).*

*Te gjitha kriteret jane permbushur nga ana jone duke zbatuar me pikmeri kerkesat e DST. KVO ne menyre te padrejte hedh dyshimin per nje drejtues teknik te shoqerise sone qe mbulon pjesen topografike te shoqerise qe ka diplome jo origjinale dhe duhet ta paraqese ate te noterizuar. Per cdo sqarim ose paqartesi KVO duhet te na drejtohet ne si Operator Ekonomik dhe nese nuk eshte e bindur ti drejtohet organeve ligjzbatuese per dyshime te tilla, nese jo nuk duhet te penalizojë shoqerine tone duke permendur ne sistem qe kemi kryer nje veprim te paligjshem. Autoriteti Kontraktor duhet te rishikoje edhe njehere vendim in e dhene nga ky komision KVO dhe te rivleresojë ofertat”.*

II.4.2. Në datën 19.08.2019 operatori ekonomik “A.SH Engineering” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtuar të njëjtat pretendime si edhe pranë autoritetit kontraktor, duke shtuar gjithashtu dhe pretendimin për anulimin e procedurës objekt ankimi. Në ankesën drejtuar KPP-së, operatori ekonomik ankimues ”A.SH Engineering” sh.p.k, pretendon se deri në datën 19.08.2019 (data në të cilën është dorëzuar ankesa pranë KPP-së), ankimuesi nuk ka marrë përgjigje nga autoriteti kontraktor në lidhje me ankesën e tij drejtuar këtij të fundit.

II.4.3. Nga informacioni dhe dokumentacioni i dërguar nga AK-ja, si dhe nga dokumentat bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik të depozituar në KPP, rezulton se në datën 19.08.2019 operatori ekonomik “A.SH Engineering” shpk ka paraqitur sërish ankesë për

mosrespektim të procedurave drejtuar Autoritetit Kontraktor, duke kërkuar anulimin e procedurës për shkak të moskthimit të përgjigjes ndaj ankesës së tij të ngarkuar në SPE, në datë 05.08.2019.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. prot.2779, datë 23.08.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit në lidhje me ankesën e datës 19.08.2019, duke mos e pranuar ankesën për anulim të procedurës, pasi ankesa që mban datën 05.08.2019 është paraqitur në mënyrë elektronike dhe jo në mënyrë shkresore pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 26.08.2019, me anë të vendimit Nr.1418/1 Protokolli, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi: Pezullimin e procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. Loti 1: REF-30645-07-17-2019, me objekt: “Loti 1: Shërbim Mbikqyrje Punimesh për objektin Rikonstruksion i shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi”, Ersekë”, me fond limit 789,110 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.07.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë”, si dhe ka kërkuar nga autoriteti kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “A.SH Engineering” shpk, një CD me të gjithë materialet e paraqitura nga shoqëritë pjesëmarrëse, si dhe të jepet informacion i hollësishëm, vërtetuar me dokumentacion, për dorëzimin pranë autoritetit kontraktor të ankesës dhe trajtimin e saj”.

II.7. Në datën 04.09.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. prot.1418/2, shkresa e autoritetit kontraktor nr.prot. 2835/2, datë 27.08.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Në datën 18.07.2019 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. Loti 1: REF-30645-07-17-2019, me objekt: “Loti 1: Shërbim Mbikqyrje Punimesh për objektin Rikonstruksion i shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi”, Ersekë”, me fond limit 789,110 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë”.

III.1.1. Në datën 29.07.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 01.08.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “MAK Studio” shpk	648.034 lekë	skualifikuar
2. “Lead consulting” shpk & “HE-SK 11”shpk	656.182 lekë	kualifikuar
3. “A.SH Engineering” shpk	668.198,2 lekë	skualifikuar
4. “Zenit& Co” shpk	686.525 lekë	kualifikuar
5. “Novatech “ shpk	697.491,67 lekë	kualifikuar

II.1.3. Operatori ekonomik ankimues “A.SH Engineering” shpk, sqaron se në datën 05.08.2019, ka paraqitur ankimin drejtuar autoritetit kontraktor në mënyrë elektronike, nëpërmjet faqes zyrtare elektronike të APP-së [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al), me anë të të cilit kundërshton skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

III.1.4. Në datën 19.08.2019 operatori ekonomik “A.SH Engineering” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe pranë autoritetit kontraktor, duke shtuar gjithashtu dhe pretendimin për anulimin e procedurës objekt ankimi. Në ankesën drejtuar KPP-së, operatori ekonomik ankimues ”A.SH Engineering” sh.p.k, pretendon se deri në datën 19.08.2019 (data në të cilën është dorëzuar ankesa pranë KPP-së), ankimuesi nuk ka marrë përgjigje nga autoriteti kontraktor në lidhje me ankesën e tij drejtuar këtij të fundit.

III.1.5. Nga informacioni dhe dokumentacioni i dërguar nga AK-ja, si dhe nga dokumentat bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik të depozituar në KPP, rezulton se në datën 19.08.2019 operatori ekonomik “A.SH Engineering” shpk ka paraqitur sërish ankesë për mosrespektim të procedurave drejtuar Autoritetit Kontraktor, duke kërkuar anulimin e procedurës për shkak të moskthimit të përgjigjes ndaj ankesës së tij të ngarkuar në SPE, në datë 05.08.2019.

III.1.6. Nëpërmjet shkresës nr. prot.2779, datë 23.08.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit në lidhje me ankesën e datës 19.08.2019, duke mos e pranuar ankesën për anulim të procedurës, pasi ankesa që mban datën 05.08.2019 është paraqitur në mënyrë elektronike dhe jo në mënyrë shkresore pranë autoritetit kontraktor.

III.1.7. Në datën 26.08.2019, me anë të vendimit Nr.1418/1 Protokolli, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi: Pezullimin e procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. Loti 1: REF-30645-07-17-2019, me objekt: “Loti 1: Shërbim Mbikqyrje Punimesh për objektin Rikonstruksion i shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi”, Ersekë”, me fond limit 789,110 lekë

pa TVSH, zhvilluar në datën 29.07.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë”, si dhe ka kërkuar nga autoriteti kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “A.SH Engineering” shpk, një CD me të gjithë materialet e paraqitura nga shoqëritë pjesëmarrëse, si dhe të jepet informacion i hollësishëm, vërtetuar me dokumentacion, për dorëzimin pranë autoritetit kontraktor të ankesës dhe trajtimin e saj”.

III.1.8. Në datën 04.09.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. prot.1418/2, shkresa e autoritetit kontraktor nr.prot. 283/2, datë 27.08.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës, me anë të të cilit Komisioni informohet si më poshtë vijon:

*“[...]Sqarojmë se operatori ekonomik “A.SH Engineering” shpk ka paraqitur ankesë në rrugë elektronike, nëpërmjet sistemit të prokurimeve publike, por nuk ka paraqitur ankesë me shkrim brenda afatit 7(shtatë) ditor nga dita e nesërme kur është vënë në dijeni (në rastin konkret) për klasifikimin e ofertave[...].”*

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht: *“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”*. *“Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit...”*. Gjithashtu, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 78 pika 6, gërma “ç”, përcaktohet se: *“Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave. Në çdo rast, vendimi i autoritetit kontraktor i komunikohet me shkrim ankimesit. Për efekt të shkurtimit të afateve kohore të procesit të ankimit, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës komunikon vendimin ankimesit edhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tij në formularin e ankesës, jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së vendimit”*. Në nenin 3 “Përkufizime”, pika 22 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Komunikimi me shkrim” është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, kopjohen dhe komunikohen, përfshirë edhe informacionet, që transmetohen ose ruhen në mënyrë elektronike”*.

III.1.10. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se ankimi pranë autoritetit kontraktor më datë 05.08.2019 (ashtu sikurse konfirmohet edhe nga vetë operatori ekonomik në formularin e ankimit që ky i fundit ka depozituar më datë 19.08.2019 pranë Komisionit të Prokurimit Publik), është dërguar tek autoriteti në rrugë elektronike dhe jo në formë shkresore sikurse

përcaktohet në nenin 63, pika 3 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, cituar në pikën III.1.9 më sipër të këtij vendimi. Komisioni sqaron se ligjvënësi megjithëse ka parashikuar si formë të komunikimit, edhe të dhënat e transmetuara në mënyrë elektronike, ka veçuar në mënyrë eksplicite komunikimin me mjete elektronike, duke përfshirë një sërë elementësh të procesesit të zhvillimit të procedurës së prokurimit publik si Publikimi i Njoftimit të Kontratës, dorëzimi dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit, vlerësimi i ofertave të dorëzuar nga operatorët ekonomikë etj, por në asnjë rast nuk ka parashikuar paraqitjen e ankimit administrativ me mjete elektronike.

III.1.11. Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues nuk ka depozituar pranë autoritetit kontraktor një ankesë të hartuar në formën e përcaktuar në ligj – pra në formë shkresore, ç’ka rrjedhimisht sjell që ankimuesi të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekjen e të gjitha shkallëve të ankimimit-përcaktuar në nenin 20, pika 2, gërma “e” e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” (neni 26, pika 1, shkronja “d” e Vendimit të mësipërm të Komisionit të Prokurimit Publik); cka si rrjedhojë përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mungesës së kushteve formale të saj, kjo referuar nenit 26, pika 3, gërma “a” të vendimit të mësipërm të Komisionit.

III.1.12. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve të ankimit sipas kushteve formale që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “A.SH Engineering” shpk, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. Loti 1: REF-30645-07-17-2019, me objekt: “Loti 1: Shërbim Mbikqyrje Punimesh për objektin Rikonstruksion i



shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi”, Ersekë”, me fond limit 789,110 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.07.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë”.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit, në zbatim të nenit 63 të LPP-së.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1418 Protokoli, Datë 19.08.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Enkeleda Bega</b>	<b>Vilma Zhupa</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**